

Nr. _____ Prot.

Patos më, ____ .01.2020

ALBPETROL SHA PATOS
FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT

Data 17.01.2020

Nga: "Albpetrol" sha - Patos

Për: "Alen-Co" shpk,

Adresa: Zharrëz, Rruga Fier-Berat km 10, Godina nr.7, Hyrja nr.2 Kati i Pare, Fier

NUIS K83213401M

* * *

Procedura e prokurimit: "Kërkesë për propozim" me mjete elektronike

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-46709-12-23-2019

Përshkrim i shkurtër i kontratës: "Blerje Tubo naftësjellësi".

Kohezgjatja e kontratës është 60 ditë nga data e lidhjes së kontratës.

Fondi limit: 7,964,897 lekë (pa TVSH).

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike: 30 Dhjetor 2019 nr.52

Njoftojmë se, kanë qenë pjesëmarrës në procedurë keta ofertues me vlerat perkatëse të ofruara:

1. Operatori ekonomik "Immi Metal" shpk me NUIS L11915005S, me vlerë oferte në total 6 529 149 lekë (pa TVSH).
2. Operatori ekonomik "Alen-Co" shpk me NUIS K83213401M me vlerë oferte në total 7 650 812 lekë (pa TVSH).
3. Operatori ekonomik "Alpha Solutions Group" shpk me NUIS L63620402U me vlerë oferte në total 5 489 442 lekë (pa TVSH).
4. Operatori ekonomik "Ra-Mi Kompani" shpk me NUIS L61327009F me vlerë oferte në total 7 300 000 lekë (pa TVSH).

Janë skualifikuar ofertuesit e mëposhtëm:

- Operatori ekonomik "Immi Metal" shpk me NUIS L11915005S, për arsyet e mëposhtme:
 - Nuk ka paraqitur certifikatën ISO 9001 2015 të operatorit ekonomik ofertues, sic kërkohet në pikën 2.3 gërma "c", kapaciteti teknik i DST-ve.
 - Nuk ka plotësuar deklaratën për paraqitje oferte të pavarur sipas shtojcës 2/1. Deklarata e paraqitur nuk është plotësuar e plotë sipas kërkesave të përcaktuara në shtojcën 2/1 të DST-ve.
 - Sipas kontratës së qirasë të paraqitur për mjetin e transportit me targa AA245YJ, certifikata e kontrollit teknik të këtij mjeti është me afat të skaduar, gjithashtu ka skaduar edhe polica e sigurimit, në kundërshtim këto me sa kërkohet në pikën 2.3 gërma "d" kapaciteti teknik të DST-ve.
 - Nuk ka paraqitur vërtetimin për shlyerjen e taksave vendore për vitin 2019 për Bashkinë

Durrës, (ka paraqitur vetëm një deklaratë) si adresë ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin sipas regjistrimit në QKB, në kundërshtim me sa kërkohet në pikën 2.2 gërma "c" kapaciteti ekonomik dhe financiar të DST-ve.

- Tabela e ofertës teknike e paraqitur nuk është e nënshkruar dhe vulosur nga operatori ekonomik, në kundërshtim me kërkesat në DST.
- Operatori ekonomik "Alpha Solutions Group" shpk me NUIS L63620402U, për arsyet e mëposhtme:
 - Nuk ka paraqitur mostra për artikujt objekt prokurimi, siç kërkohet në pikën 2.3 gërma "g" e DST-ve.
 - Faturat dhe kontratat e paraqitura nuk konsiderohen si eksperiencë e ngjashme me objektin e prokurimit (tubo për transportin e naftës), siç kërkohet në pikën 2.3 kapaciteti teknik gërma "a".
 - Në katalogun e paraqitur nuk evidentohen të gjitha specifikimet teknike të kërkuara në DST.
- Operatori ekonomik "Ra-Mi Kompani" shpk me NUIS L61327009F, për arsyet e mëposhtme:
 - Nuk ka paraqitur mostra për artikujt objekt prokurimi, siç kërkohet në pikën 2.3 gërma "g" e dst-ve.
 - Faturat dhe kontratat e paraqitura nuk konsiderohen si eksperiencë e ngjashme me objektin e prokurimit (tubo për transportin e naftës), siç kërkohet në pikën 2.3 kapaciteti teknik, gërma "a".
 - Pjesët e katalogut ku tregohen specifikimet teknike për mallin objekt prokurimi nuk janë të përkthyer dhe të noterizuara, siç kërkohet në pikën 2.3 gërma "g" e DST-ve.

* * *

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë "Alen-Co" shpk, me adresë Zharrëz, Rruga Fier-Berat km 10, Godina nr.7, Hyrja nr.2 Kati i Pare, Fier, me NUIS K83213401M, se oferta e paraqitur, me një vlerë të përgjithshme prej 7 650 812 (*shtatë milion e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë e tetëqind e dymbëdhjetë*) lekë pa TVSH, është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni të lutur të paraqisni pranë Drejtorisë së Prokurimit Publik të "Albpetrol" sha, rruga Fier – Patos km 7, Fier, sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda 5 (pesë) ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, tenderi do të anulohet, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit për Prokurimet Publike nr. 9643 datë 20.11.2006.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë 09.01.2020.

Nuk ka patur ankesa.

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR

Erjola MUKA